



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim Konsekutiv

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof.Asoc.Dr. Alma Pinari
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 15 leksione / 25 seminare
Viti akademik: 2024-2025, Viti III , Semestri 2
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: alma.pinari@unitir.edu.al
almapinari@gmail.com

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:Në përfundim të modulit synohet:zhvillimi i aftësive të interpretimit konsekutiv të teksteve me tematikë dhe shkallë të ndryshme vështirësie nga gjuha ruse në shqipe dhe anasjelltas;zhvillimi i aftësive për të ekzekutuar siç duhet, në përputhje me tekstin dhe standardet e përdorimit, dhe tipologjinë e teksteve në gjuhën e caktuar, transmetimin me gojë të një mesazhi nga gjuha e huaj në gjuhën amtare, dhe anasjelltas;

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të njohë se si të:

- 1.Të ushtrojë kompetencën e analizës përkthimore, për të përcaktuar qëllimin e transmetimit, karakterin e tij receptor dhe llojin e tekstit të përkthyer;
- 2.Të zgjedhë strategjinë e përgjithshme në përkthim, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe llojin e tekstit origjinal;
- 3.Të kryejë një përkthim me gojë të teksteve brenda programit të përcaktuar në subjekte me shkallë të ndryshme të vështirësie, duke përdorur metodat dhe teknikat themelore të përvetësuara, semantike, stilistike etj.;

Rezultatet e pritshme:

- 1.Zhvillimi i aftësive të përkthimit konsekutiv – Studenti do të jetë në gjendje të interpretojë në mënyrë korrekte dhe të rrjedhshme tekste me vështirësi të ndryshme nga gjuha ruse në shqipe dhe anasjelltas, duke respektuar qëllimin dhe natyrën e komunikimit.
- 2.Aftësi për të analizuar dhe përcaktuar qëllimin e përkthimit – Studenti do të ushtrojë kompetencën analitike për të identifikuar llojin e tekstit dhe kontekstin e përkthimit, si dhe të zgjedhë strategjinë përkatëse për transmetimin efektiv të mesazhit.
- 3.Zbatimi i teknikave përkthimore në praktikë – Studenti do të jetë në gjendje të realizojë përkthim me gojë duke përdorur teknikat themelore semantike dhe stilistike, duke përshtatur mesazhin sipas kontekstit dhe standardeve gjuhësore të gjuhës përkatëse.